



Botim i Qendrës “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Unë nuk do ta godisja **KURRË** një grua...

do të doja që im atë të thoshte të njëjtën gjë...!

Broshurë për fëmijët dhe të rinjtë

Tiranë, nëntor 2005

Kjo broshurë botohet në kuadrin e projektit “*Fushatë ndërgjegjësimi kundër dhunës ndaj gruas*”, i financuar nga NWP (Network Women’s Program), New York.

Botimi i kësaj broshure është financuar nga NWP, Kryqi i Kuq Spanjoll dhe Kryqi i Kuq Shqiptar.



Përgatiti: Blerta Picari

© 2005 Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për Qendrën “Aleanca Gjinore për Zhvillim”, Tiranë, Shqipëri.

Adresa:

Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim”

Kutia postare 2418, Tiranë

Tel. & Fax: (355) 4 255514/5

E-mail: info@women-center.tirana.al

Këtë botim mund ta gjeni në formë elektronike në adresën:

<http://www.women-center.org.al>

Design & Layout: Vjollca Ruvina

Shtypur në shqypshkronjën “PEGI”

Tirazhi 2000 kopje

ISBN 99927-974-6-0

Përmbajtja

Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën, kurse të gjithë ne, po!	5
Dhuna në familje: Pasojat tek fëmijët dhe të rinjtë	8
Dhuna në familje - një sjellje e mësuar	9
Efektet e dhunës tek fëmijët dhe familjet	11
Fëmijët dhe dhuna ndaj të afërmeve të tyre	12
Profili shqiptar - Dhuna nuk është disiplinë!	13
Dhuna fizike ndaj dhe ndërmjet të rinjve	16
Dhuna seksuale ndaj fëmijëve dhe të rinjve	19
Efektet afatgjatë	19
Trafikimi - një e ardhme e dhunuar!	21
Dhuna dhe imazhet në media	22
Parandalimi i dhunës - një përgjegjësi shoqërore	24
Kuadri ligjor	24
Përgjegjësitë e shoqërisë	24
Këshilla për prindërit	27
Kontakte të nevojshme	29
Referencat	32



Vetëm ligjet nuk mund ta ndalojnë dhunën,

kurse të gjithë ne, po!¹

Nëse do të zhvillohej midis shtetesh, do ta quanim luftë. Nëse do të ishte një sëmundje, do ta quanim epidemi. Nëse do të ishte një derdhje e naftës diku në det, do ta quanim një katastrofë. Por, është diçka që po u ndodh grave dhe konsiderohet si një çështje e jetës së përditshme. Është dhuna ndaj grave. Është ngacmimi seksual në punë dhe abuzimi seksual i vajzave të reja. Është rrahja ose dhuna fizike që secila prej miliona grave vuan çdo ditë. Është përdhunimi brenda shtëpisë ose në një takim. Është vrasja.

Nuk është se ka ndonjë armik sekret që tërheq këmbëzën e armës. Nuk ka ndonjë virus të padukshëm që çon në vdekje. Janë vetëm meshkujt. Jo të gjithë meshkujt, por mund të themi shumë prej tyre. Në disa vende shumica e meshkujve kurrë nuk do të jenë të dhunshëm ndaj një gruaje. Ndërsa në vende të tjera, pjesa më e madhe e meshkujve do ta konsiderojnë si një të drejtë që e

fitojnë që në lindje: të bëjnë çfarë të duan dhe kur të duan ndaj grave.

Por cilët janë këta meshkuj? Thjesht meshkuj normalë, që vijnë nga të gjitha shtresat sociale dhe të të gjitha ngjyrave dhe moshave. Të pasur, të varfër që punojnë tokën, apo meshkuj që qëndrojnë në zyrë pas një tavoline. Të gjithë këta janë meshkuj normalë, megjithatë, kanë ndihmuar në krijimin e një klime frike dhe mosbesimi tek gratë. Shumë nga gratë, nënat dhe motrat, të dashurat dhe bashkëshortet tona nuk ndihen të sigurta në shtëpitë e tyre. Natën ato nuk mund të shkojnë të blejnë diçka për të ngrënë, pa parë se kush po ecën pas tyre. Është e vështirë që ato të ndezin televizorin dhe të mos shohin meshkuj që shfaqin brutalitetin e tyre ndaj femrave dhe meshkujve të tjerë. Megjithëse këto gra kanë marrëdhënie me meshkuj që janë të sjellshëm dhe të ndjeshëm ndaj tyre, ato prapëseprapë nuk mund t'u besojnë plotësisht të gjithë

¹ Ky mesazh ndërkombëtar transmetohet nga Fushata e Fjongove të Bardha: www.whiteribbon.com

meshkujve. Të gjitha femrat ndihen "të burgosura" brenda një kulture të dhunës.

Dhuna e meshkujve ndaj femrave nuk është një sjellje normale. Meshkujt kanë krijuar kultura ku përdorin dhunën edhe ndaj meshkujve të tjerë, ku ne shfrujmë dhunën në habitatin natyror, ku ne shohim dhunën si mjetin më të mirë për të zgjidhur dallimet me kombeve, ku çdo djalë detyrohet dhe nxitet që të luftojë dhe ku meshkujt kanë forma të pushtetit dhe të privilegjit që femrat nuk mund t'i shijojnë.

Meshkujt janë përcaktuar si pjesë e problemit. Por, kjo fushatë beson se meshkujt munden dhe duhet të jenë pjesë e zgjidhjes së problemit. Përballimi i dhunës së meshkujve nuk kërkon asgjë më shumë sesa një angazhim për t'u dhënë drejtësi grave, si dhe një ridimensionim të asaj se çfarë do të thotë të jesh mashkull, duke zbuluar kuptimin e mashkulloritetit, për të cilin nuk ka nevojë që të derdhet gjak.

Me të gjithë dashurinë, respektin dhe mbështetjen për gratë e pranishme në jetën tonë:

- Ne nxisim të gjithë meshkujt në vendin tonë të vendosin në bluzë një fjongo vjollcë ose ta varin atë në shtëpitë e tyre, në makina ose në vendin e punës, çdo vit për një ose dy javë, duke filluar nga 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave. Vendosja e një fjongoje të tillë është një zotim publik që kurrë të mos krëjmë, falim ose të qëndrojmë të heshtur në rastet e dhunës ndaj grave. Fjongoja vjollcë simbolizon një thirrje për të gjithë meshkujt që të ulin duart poshtë në luftën ndaj motrave tona.
- Ne u kërkojmë bashkimeve të ndryshme, shoqatave të profesionistëve, grupeve të studentëve, kompanive të ndryshme, institucioneve fetare, medias, organizatave qeveritare dhe atyre jo-qeveritare që ta bëjnë këtë çështje një prioritet të axhendave të tyre.
- Ne nxisim qeverinë që të aprovojë ligje të përshtatshme kundër të gjitha formave të dhunës ndaj grave, dhe të financojë

programe për të mbijetuarit e kësaj dhune, si strehëza për gratë e dhunuara dhe qendra për rastet e përdhunimeve, si dhe institucione që ofrojnë shërbime për meshkujt e dhunshëm.

- Ne bëjmë thirrje për programe edukative dhe ndërgjegjësimi, në shkallë të gjerë, në shkolla dhe vendet e punës, për punonjësit e policisë dhe gjykatësit, lidhur me çështjen e dhunës së ushtruar nga meshkujt.
- Ne besojmë se respekti për gratë e vajzat, si dhe barazia e drejtësia midis grave dhe burrave janë detyrimisht të nevojshme për t'i dhënë fund dhunës.
- Ne nxisim meshkujt që të organizojnë fushata lokale dhe kombëtare kundër dhunës ndaj gruas, të cilat të jenë të hapura për të gjithë djemtë dhe burrat e të gjithë spektrave politikë, socialë dhe ekonomikë.

Kjo broshurë është përgatitur për të paraqitur rrjedhojat individuale dhe shoqërore të dhunës kundrejt fëmijëve dhe të rinjve dhe mënyrat se si ne të gjithë mund të ndihmojmë për të parandaluar këtë dukuri të shëmtuar të shoqërisë tonë. Disa shembuj janë sjellë për të paraqitur para syve tanë atë çka ne përjetojmë herë pas here në jetën e përditshme dhe nuk bëjmë asgjë për ta ndryshuar.

Me fuqi dhe dashuri, ne e angazhojmë veten tonë që të punojmë përkrah grave për t'i dhënë fund dhunës në familje.

Dhuna në familje: Pasojat tek fëmijët dhe të rinjtë

“Dhunë është çdo lloj sjellje apo qëndrim ndaj fëmijës që dëmton ose rrezikon mirëqenien e tij/saj emocionale, fizike dhe mendore dhe, për pasojë shkakton ndërprerje apo vonesa në procesin normal të zhvillimit”.² Bazuar në legjislacionin shqiptar [...fëmijë quhet çdo qenie njerëzore nën moshën 18 vjeç duke përjashtuar ato raste ku sipas ligjeve në fuqi mosha e pjekurisë arrihet më parë...]

² Abuzimi i Fëmijëve në Familjet Shqiptare” (Draft) Tiranë-2005, përgatitur nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri- CRCA, Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri- IRCCRA, Olof Palme International -me qendër në Suedi dhe Defence for Children International-DCI.

► ***Dhuna në familje - një sjellje e mësuar***

Shpeshherë, vërejmë rrugëve të qyteteve tona fëmijët apo dhe të rinjtë që grinden me njëri-tjetrin, duke përdorur një fjalor, fjalët e të cilit dhe vetë ata nuk i kuptojnë plotësisht. Dhe shpesh, të gjithë ne themi: “Ku po shkon ky brezi i sotëm?!”

Përgjigjja është se kjo dukuri është një rreth vicioz që përsëritet dhe mbahet i heshtur në sferën personale dhe se sjellja e fëmijëve dhe të rinjve të sotëm ka rrënjë në strukturën e ambientit familjar apo shoqëror ku ata vërtiten. Dhe ai ambient jemi ne, të gjithë së bashku. Pikërisht në këtë ambient fëmija kushtëzohet të mendojë se dhuna është një mënyrë zgjidhjeje ndaj problemeve, sidomos atyre që shkaktohen nga frika dhe pasiguria. Dhe këto probleme të brumëzuara që në fëmijëri, marrin formë dhe ngurtësohen në shprehi të përditshme të një të riu apo të reje, të cilët formojnë të ardhmen e një kombi. Ky brez

Historia e Migenës:

Migena, 13 vjeçe, ka frikë të kthehet në shtëpi. Ajo mezi pret diellin të lindë dhe të shkojë në shkollë ku nuk duhet të dëgjojë prindërit që grinden dhe babain që rreh të ëmën sa herë që është i pirë. Dhe ai pi shpesh. Migena shpesh kërkon strehë në dhomën e të vëllait, i cili është 3 vjet më i madh. Por, ai me padurim dhe i zemëruar e nxjerr nga dhoma me të shara dhe shtyrje. Herën e fundit, ai e shtyu aq fort sa asaj iu përplas koka në murin e korridorit, duke lënë një gungë të madhe në anën e majtë të ballit. Për të, shkolla është i vetmi vend i qetë. Shokët dhe shoqet e saj nuk dinë asgjë për problemet e familjes së saj dhe aty ajo mund të fshihet dhe të shtiret sikur gjithçka është ashtu siç duhet të jetë.

Historia e Anisës:

Edukatore Elda ka vënë re shpeshherë se kur 5-vjeçarja Anisaluam meshokët dhe shoqet në kopësht, është gjithmonë e tendosur dhe në disa momente shpërthen në zemërim kundrejt tyre, duke i bërtitur se ata nuk duan ta pranojnë për të luajtur me të dhe hiqet mënjanë. Në raste të tjera, ajo vë re se Anisa e ka vëmendjen të përqendruar gjatë ditës dhe fërkon gjymtyrët e saj. Kur përparësja është e ngritur deri në bërryl, edukatore Elda ka vënë re disa shenja të mavijosura tek kyçi i dorës dhe në pjesën e poshtme të parakrahut. Ajo është e shqetësuar për shenjat pasi ato zhduken dhe rikthehen përsëri. E ëma e Anisës vjen ta marrë të bijën çdo ditë dhe një ditë ajo e ndalon për ta pyetur në lidhje me shenjat. Përgjigjja është e prerë dhe justifikohet nga pakujdesitë e Anisës kur luan. Gjatë bisedës edukatore Elda vë re se e ëma e Anisës ka gjithashtu shenja të mavijosura në parakrahë. Ajo nuk e shtyn bisedën më tutje dhe çështja mbyllet aty, por sjellja agresive e Anisës vazhdon.

do të edukojë fëmijët e tyre dhe të njëjtat shprehi do të trashëgohen. Deri kur....?!

- *Çfarë mendoni ju se i shkakton shenjat në gjymtyrët e Anisës?*
- *Po të së ëmës?*
- *Vini veten tuaj në vend të edukatores. Çfarë do të kishit bërë ju në këtë rast?*
- *A do të ndryshonte përgjigjja juaj n.q.s. fëmija juaj do të ishte shoqja/shoku i/e ngushtë i/e Anisës?*

Dhuna ndaj grave ndikon negativisht në miliona fëmijë çdo vit dhe shpesh është e shoqëruar nga forma të ndryshme të dhunës (verbale, fizike, emocionale dhe psikologjike), e cila shkatërron jo vetëm jetë dhe familje, por komunitete të tëra. Shumica e burrave (të cilët janë zakonisht dhe abuzuesit) përveç dhunës kundrejt bashkëshortes, shpesh ushtrojnë dhunë dhe ndaj fëmijëve dhe kjo dukuri ka pasoja negative në të gjithë komunitetin përreth. Nga një studim i kryer në Shtetet

e Bashkuara në vitin 1990, 50-70% të burrave të cilët abuzojnë me partnerët e tyre, gjithashtu abuzojnë dhe me fëmijët. Për më tepër, ka një lidhje të madhe ndërmjet dhunës së ushtruar ndaj partneres dhe abuzimit seksual ndaj fëmijës vajzë. Është vështirë të identifikohen forma të pastra të dhunës, si p.sh. vetëm ajo emocionale apo vetëm ajo fizike. Zakonisht aty ku ekziston njëra formë është shumë e mundur të ekzistojë dhe tjetra.³ Gjithashtu, ndikimi mbi fëmijët që janë dëshmitarë të dhunës në familje, është i njëjtë me pasojat e abuzimit të fëmijës prej njërit prej prindërve dhe kjo dëshmi dhune ka një ndikim të madh për të qenë të dhunshëm në moshë të re. Për më tepër, neglizhimi është gjithashtu një formë dhune, pasi prindi i mohon fëmijës të drejtën e ushqyerjes, higjenës, shkollimit etj., dhe vërteton mungesën e mbikqyrjes apo dhe braktisjen.

► ***Efektet e dhunës tek fëmijët dhe familjet***

Nga një studim i kryer nga Instituti Kombëtar i Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara, është konstatuar se n.q.s. një fëmijë është abuzuar ose keqtrajtuar, ka një mundësi më të lartë (53% më shumë se një fëmijë normal) të arrestohet si adoleshent, dhe 38% më shumë si i rritur për t'u përfshirë në një krim të dhunshëm. Pra, dhuna e përjetuar në fëmijëri, është një faktor negativ që përmban rrezikshmëri përse i përket sjelljes së individit në të ardhmen. Për vajzat e reja, një faktor negativ që ndikon në një shkallë të lartë sjelljen e dhunshme kriminale gjatë rinisë, është abuzimi seksual. Shpeshherë, zgjidhja e përkohshme e kësaj situatë për vajzat është largimi nga shtëpia në një moshë të re, e cila shpeshherë çon drejt rrugës së prostitucionit. Nga një studim i

³ Abuzimi i Fëmijëve në Familjet Shqiptare” (Draft) Tiranë-2005, përgatitur nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri- CRCA, Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri- IRCCRA, Olof Palme International -me qendër në Suedi dhe Defence for Children International- DCI, fq. 6.

bërë në fillim të viteve 1990 në Shtetet e Bashkuara, rreth 95% e vajzave adoleshente që ushtronin prostitucion, ishin të abuzuara seksualisht.

► **Fëmijët dhe dhuna ndaj të afërmve të tyre**

Siç u përmend më sipër, edhe pse një fëmijë mund të mos jetë keqtrajtuar fizikisht, dhuna në familje shkakton një seri problemesh psikologjike dhe emocionale, duke kufizuar mundësitë e fëmijëve për një jetë normale, pasojë kjo që mund të vazhdojë gjatë gjithë jetës. Fëmijët që kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje, zakonisht ushtrojnë një sjellje agresive dhe jo-shoqërore, të frikësuar, të dëshpëruar, dhe traumatike në krahasim me fëmijët të cilët nuk kanë pasur të tilla përvoja. Dhuna në familje gjithashtu, ndikon mënyrën sesi këta fëmijë do të jenë në gjendje të përballojnë problemet në të ardhmen e tyre. Pasoja variojnë duke pasur parasysh se sa kohë ka

zgjatur dhuna, llojin e saj, sa ka qenë një fëmijë i përfshirë në të, mënyra se si një fëmijë ka mundur ta përballojë atë, dhe ambientin përreth, i cili mund të ketë pasur kushte më të përshtatshme për zgjidhjen e problemit. Në rastin e përjetimit të dhunës tek njëri prej prindërve, problemet e trashëguara nga dhuna në familje, varen nga moshja dhe gjinia e fëmijës, kohëzgjatja e dhunës së ushtruar dhe marrëdhënia e fëmijës me prindin e dhunuar dhe personat e tjerë përreth.

- *A mendoni ju se dhuna në familje duhet të mbetet një çështje personale, brenda mureve të shtëpisë?*
- *Si mendoni ju që mund ta ndihmonte Ana fqinjën e saj dhe Andin në këtë rast?*
- *Cilat mendoni ju janë pasojat afatgjatë të dhunës së ushtruar kundrejt së ëmës tek Andi? Çfarë kompleksesh do të trashëgojë ai në lidhje me të atin dhe të ëmën, apo me partneren e tij në të ardhmen?*

► **Profili shqiptar – Dhuna nuk është disiplinë!**

Nga një studim i UNICEF i botuar në Shtator të 2003-it thuhet se *“megjithëse të dhënat zyrtare mungojnë, raportet e mbledhura aty këtu tregojnë që, dhuna në familje ka pësuar një rritje gjatë këtyre 12 viteve të tranzicionit. Në kushtet e një papunësie të madhe, burrat ndihen të pamundur në përpjekjet e tyre për të siguruar bukën e gojës për familjen. Problemet shoqërore kanë zbehur rolin tradicional të burrit për të mbajtur familjen dhe kanë minimizuar rolin tradicional të barazisë gjinore, duke mos krijuar asnjë hapësirë për formimin e sjelljeve pozitive ndaj këtij fenomeni.”*⁴

Përveç kësaj, nga një studim i kryer nga Qendra e Trajtimit Multidisiplinor për Problemet e Keqtrajtimit të Fëmijëve

⁴ Dhuna në familje shkatërron jetën e grave dhe të fëmijëve si dhe pengon zhvillimin mëtejshëm të Shqipërisë, UNICEF 17 Shtator, 2003.

Historia e Andit:

Andi është 7 vjeç dhe komshija e tij Teta Ana e merr shpesh në këndin e lojrave për të luajtur bashkë me vajzën e saj moshatare. Kur të dy fëmijët luajnë kukafshehurazi, ajo vë re se Andi fshihet dhe nuk del për një kohë të gjatë dhe shpesh Ana dhe vajza e saj duhet ta kërkojnë atë, sepse duhet të kthehen në shtëpi. Andi gjithmonë kapet pas një objekti dhe Ana duhet ta ‘shkulë’ prej tij për ta çuar në shtëpi. Kur ajo ia arrin, ai bërtet dhe vetëm pas një përpjekje të gjatë qetësohet dhe vazhdon rrugën drejt kthimit. Ana e di që prindërit e Andit kanë probleme pasi natën vonë dëgjojnë zënat e tyre, objekte që thyhen dhe të qara. Ka ditë që Ana nuk e sheh të dalë nga dera të ëmën e Andit dhe nuk guxon ta pyesë se çfarë mund të ketë ndodhur. Ana mendon se marrëdhëniet e çiftit duhet të mbeten gjithmonë brenda mureve të shtëpisë.

gjatë vitit 2003, shumë prindër dhe mësues në Shqipëri akoma mendojnë se disiplina fizik bën pjesë në “rritjen dhe edukimin” e fëmijëve të tyre. Rreth 75.08% e prindërve dhe 71.6% e mësuesve, konfirmojnë se disiplina fizike është një dukuri e zakonshme në Shqipëri. Rreth 31.84% e prindërve dhe 39.9% e mësuesve të intervistuar, ishin të mendimit se disiplina fizik gjatë fëmijërisë nuk i kishte dëmtuar fëmijët e tyre, por përkundrazi ata kishin mësuar ndryshimin mes së mirës dhe së keqes. Në këtë studim ishin përfshirë dhe 1000 nxënës të moshave 6-12 vjeç dhe 13-18 vjeç. Nga ky studim u konstatua se:

- 58.1% e fëmijëve të intervistuar të këtyre grupmoshave kishin përjetuar dhunë emocionale në familjet e tyre.
- 40.7% e fëmijëve u shprehën se ishin nënat të cilat abuzonin emocionalisht me ta dhe 17.4% u shprehën se ishin baballarët.
- 36% e fëmijëve konstatuan se nënat e tyre abuzonin me ta fizikisht ndërsa 21.5% thanë se ishin baballarët.
- 22.9% e tyre u shprehën se baballarët e tyre përdornin alkool, gjë e cila rezultoi në zënkat ndërmjet prindërve.
- 73.3% e fëmijëve vërtetuan prezencën e keqtrajtimit të fëmijëve nëpër shkollë.
- 11% e fëmijëve kishin pasur ngacmime seksuale dhe 4% e tyre i kishin përjetuar ato në ambientin familjar.
- 4% e fëmijëve pranuan përjetimin e dhunës seksuale.
- Kur u pyetën mbi mënyrat e parandalimit të keqtrajtimit të fëmijëve, rreth 80% e tyre u shprehën pozitivisht mbi funksionimin e qendrave të posaçme dhe të specializuara si diçka efektive dhe treguan shumë pak besim tek strukturat shtetërore të çdo niveli.
- Nga telefonatat e bëra nga fëmijët dhe të rinjtë në MCMCM, (768 nga Nëntor 2001 – deri në Prill 2005), si dhe rastet e ndjekura nga MCMCM, përkëshillim dhe trajtim (më shumë se 80 raste gjatë periudhës Janar 2002 – Prill 2005), rezultoi se:
 - 38% e telefonatave u takojnë

- rasteve të fëmijëve, viktima të dhunës në familje; dhe*
- 25 raste të këshillimit ballë për ballë i takojnë dhunës në familje.

Në qoftë se do të analizonim profilin e fëmijëve shqiptarë të dhunuar, një studim i kryer nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri- CRCA me Qendrën e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri- IRCCRA, Olof Palme International dhe Defence for Children International- DCI., do të ishte shumë më vlerë referimi i profilit të fëmijët e dhunuar të strehuar në Strehëzën e Tiranës:

Mosha: Fëmijët e trajtuar në Strehëz përgjithësisht kanë qenë të moshave të ndryshme. Shpërndarja është afërsisht në nivele të barabarta: 28% kanë qenë të grupmoshës 0-3 vjeç, nga të cilët rreth ½ e tyre kanë lindur në Strehëz. 15% e fëmijëve i përkasin grupmoshës 4-6 vjeç, 24% grupmoshës 7-10 vjeç dhe 19% grupmoshës 11-14 vjeç.

Vetëm raste të veçanta ka patur fëmijë më të rritur se 14 vjeç për shkak të kriterëve të pranimit në Strehëz. Edhe ato pak raste kanë qenë vajza. Siç shihet edhe nga shifrat, dhuna nuk ka përjashtuar fëmijët e asnjë grupmoshe, ata bëhen viktima pavarësisht nëse janë mjaft të vegjël apo edhe relativisht të rritur. Kuptohet që fëmijët e moshave më të rritura 7-14 vjeç arrijnë më mirë të kuptojnë se çfarë u ka ndodhur dhe të përshkruajnë situatat e dhunshme që kanë përjetuar.

Gjinia: Fëmijët e abuzuar që janë trajtuar në Strehëz kanë qenë, si djem dhe vajza në një raport pothuajse të njëjtë, konkretisht 47% vajza, 53% djem. Mund të dallojmë këtu që djemtë raportojnë më tepër abuzim fizik sesa vajzat, ndërsa rastet e abuzimit seksual janë raportuar kryesisht tek vajzat.

Lloji i dhunës: Përsa i përket llojit të dhunës që është ushtruar tek fëmijët ajo ka qenë e të tre llojeve të sipërpërmendur. Kështu, 20% e fëmijëve rezulton se janë abuzuar

fizikisht, 3% e tyre seksualisht ku përfshihen rastet e ngacmimit seksual nga babai dhe 100% e fëmijëve kanë përjetuar dhunë emocionale, si: presion, izolim, dhunë ekonomike, si dhe privim nga të drejtat e tyre.

Rastet e trajtuara në strehëz mund të grupohen sipër, vetëm duke u ndalur tek forma mbizotëruese e dhunës, pasi në fakt, raste të pastra nuk ka. Të gjithë fëmijët kanë përjetuar dhunë emocionale, pasi edhe ai që rrihet, edhe ai/ajo që shahet, por edhe ai/ajo që ngacmohet seksualisht, ndihet i/e pambrojtur, i/e frikësuar, i/e fyer dhe për të jeta kthehet në një ferr të vërtetë.

Dhuna fizike ndaj dhe ndërmjet të rinjve

Nëse nuk merren masa për parandalimin e saj, dhuna kundrejt një fëmije vazhdon dhe në moshën e adoleshencës. Shumë adoleshentë të dhunuar ose që kanë jetuar në familje të dhunshme, kanë tendencë të ushtrojnë dhunë në marrëdhëniet

Historia e Benit:

Beni vjen në Strehëz më nënën e tij, pas një përvoje dhune ekstreme që ushtrohej ndaj nënës edhe në sy të djalit. Beni ishte vetëm 3 vjeç, shumë i dobët fizikisht, i papërqëndruar, shumë i lëvizur, në kufinj të hiperaktivitetit, agresiv dhe i paparashikueshëm në sjelljet dhe shpërthimet e tij. Nuk i pëlqente të shoqërohej apo të luante me fëmijët e tjerë apo me të rriturit. Vazhdimisht klithte. Klithma ishte mënyra e tij e komunikimit, kur kërkonte apo kur i kërkohet diçka. Klithmat e nervozuara dukej se ishin imitime të mënyrës së komunikimit të babait të tij. Të folurit nuk ishte i zhvilluar normalisht, mbase edhe për arsyen e mësipërme, por edhe për faktin se ai jetonte në të njëjtën banesë me gjyshërit dhe xhaxhain dhe se ata të gjithë kishin probleme të komunikimit. Sipas fjalëve të nënës së Benit, në familjen e tyre vetëm bërtitej, njerëzit rriheshin, përplaseshin objektet e shtëpisë, thyheshin karrike dhe familjarët ishin gjithmonë të tensionuar. Ai gjuante me shkelma fëmijët

dhe punonjëset dhe po të të gjente pa mendje mund edhe të të qëllonte apo të të kafshonte. Ai ishte shumë i lidhur vetëm me nënën e tij. Por, edhe kjo lidhje e realizuar në kushtet e mbingarkesës emocionale, nuk ishte normale. Flinte me të ëmën në të njëjtin shtrat dhe sjellja trupore nuk ruante distancat personale. Kjo lloj sjellje u bë objekt i vëzhgimeve dhe vlerësimeve të stafit, deri sa u arrit të zbulohet se djali kishte qenë i pranishëm kur babai e abuzonte seksualisht të ëmën, kur pasi e rrihte e zhvishte dhe e linte ashtu me orë të tëra. Në një nga ditët e qëndrimit në Strehëz, djali 3 vjeçar ju afrua njëres nga punonjëset të Strehëzës duke imituar një marrëdhënie intime. Pas bisedave me të ëmën, u zbulua se fëmija edhe mund të kishte qenë viktimë e dhunës seksuale të ushtruar ndaj tij nga i ati. Si konkluzion, mund të themi se Beni ishte një fëmijë tipik i dhunuar. Tek ai takoheshin të gjitha karakteristikat e një fëmije seksualisht, fizikisht dhe emocionalisht të dhunuar.”¹

e ardhshme me partnerin/en dhe njerëzit përreth. Jeta në një komunitet ku përdoren armët, droga, alkooli; ku ka përqindje të lartë krimi; kur aplikohet disiplinë e papërgjegjshme dhe e pajustificuar nga prindërit, izolimi ndaj jetës shoqërore dhe ndaj edukimit, i vë fëmijët dhe të rinjtë në një ambient me shumë rrezikshmëri për t’u përfshirë në veprimtari të dhunshme. Të tillë adoleshentë janë më të prirur të vetëvriten, të abuzojnë me drogë dhe alkool, të largohen nga shtëpia në një moshë të re, dhe të përfshihen në krime dhe prostitucion. Studime të ndryshme në Shtetet e Bashkuara kanë treguar se adoleshentët e dhunshëm vuajnë pasoja të rënda psikologjike, nga dhuna fizike e ushtruar nga njëri prej

⁵ Abuzimi i Fëmijëve në Familjet Shqiptare” (Draft) Tiranë-2005, përgatitur nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri- CRCA, Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri- IRCCRA, Olof Palme International -me qendër në Suedi dhe Defence for Children International- DCI, fq. 17, 22.

prindërve, apo nëse janë rritur në ambiente ku janë përdorur armët. Dhuna e përjetuar si një fëmijë është gjithashtu e shoqëruar me depresion, simptoma traumatike, dhe vetëvlerësim i ulët ndër gratë dhe burrat. Rezultatet e kërkimeve në Shtetet e Bashkuara kanë arritur në konkluzione se burrat, të cilët kanë qenë të abuzuar kur kanë qenë fëmijë, janë 2 herë më shumë të prirur të abuzojnë me gratë e tyre se ata që kanë pasur një fëmijëri jo të dhunshme. Dhuna në familje dhe ndaj fëmijëve e vë brezin e ri në një rrezik më të madh për t'u përfshirë në sjellje kriminele dhe traumatike dhe rezulton në një ulje të mundësive për të pasur një jetë normale brenda familjes dhe në komunitet.

Dhuna ndërmjet të rinjve, ashtu si dhe dhuna në familje është një sjellje e forcuar dhe manipulative, me të cilën njëri prej partnerëve kërkon të kontrollojë tjetrin. Një dukuri e tillë vihet re në forma të ndryshme si: abuzimi emocional, fizik, seksual, kufizimi i pavarësisë, izolimi nga shoqëria, kërcënimet, fajësimi etj. Por, janë

incidentet e dhunës fizike ato që i bëjnë të rinjtë të kuptojnë se po dhunohen.

Sipas një studimi të kryer në Shtetet e Bashkuara në 2001, për të konstatuar dhunën ndaj dhe ndërmjet adoleshentëve, u vu re se ndër adoleshentët e moshës shkollore të mesme:

- *1 në 5 vajza ishte viktimë e dhunës fizike apo seksuale nga partneri.*
 - *Gjithashtu u konstatua se vajzat e grupmoshës 16 deri në 24 vjeç kishin përqindjen më të lartë të dhunimit në familje apo nga partneri.*
 - *43% të vajzave të dhunuara raportuan se dhunimi kishte ndodhur në objektet apo territorin e shkollës.*
 - *40% e vajzave adoleshente njihnin dikë që ishte abuzuar nga partneri.*
 - *30% e të gjitha vrasjeve të adoleshentëve në SH.B.A. bëhen nga partneri.*
- *Si mendoni ju, a është Alma një viktimë abuzimi? Cila është mënyra e abuzimit e përdorur nga Mondit?*

- *Çfarë mund të bëjë Alma për të fituar pavarësinë dhe të integrohet sërish në shoqërinë e saj?*
- *Çfarë mund të bëjnë prindërit e Almës kur vërejnë një ndryshim në sjelljen e vajzës së tyre? Si mund të hapin ata dialogun për të adresuar shqetësimet e Almës? Si mund ta ndihmojë shoqja e ngushtë në këtë rast?*

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve dhe të rinjve

Fëmijët janë qeniet më të dobëta përsa i përket vetëmbrojtjes dhe dhunimi seksual lë shumë pasoja të thella në jetën e tyre prej adoleshenti apo të rrituri. Ai mund të ndodhë nga pjesëtarët e familjes (inçesti), të njohur, partnerët (në moshën adoleshente) dhe të panjohurit.

► **Efektet afatgjata**

- Vihet re se shumica e vajzave që dhunohen seksualisht kanë tendencën të bien në dëshpërim

Historia e Almës:

Alma, një vajzë 17 vjeçare i pëlqen të dalë me shoqet dhe shokët e klasës. Në veçanti, asaj i pëlqen shumë loja bowling. Ka kohë që nuk ka vajtur me shoqërinë për të luajtur. Shoqja e saj e ngushtë këmbëngul gjithmonë që të premtete ajo të shkojë të luajë me ta. Por, Alma tërhiqet. Që kur ka filluar të frekuentojë Mondin, të cilin ajo e pëlqen shumë, nuk del si më parë. Ai e merr në telefon çdo ditë dhe e pyet imtësisht për gjithçka që mund të ketë ndodhur apo për planet e saj. Ai e pret kur ajo del nga shkolla dhe pasi kalojnë pak kohë së bashku, e çon në shtëpi. Ata nuk dalin kurrë për t'u argëtuar me të tjerë. Gjatë pushimeve të verës kur Alma ishte në plazh, ai shkonte atje çdo ditë me disa nga shokët e tij. Ngado që ajo të rrotullohet, gjen Mondin dhe ky kontroll prej tij sa vjen e rëndohet. Alma ndihet e ndrydhur dhe nga mërzitja e kohëve të fundit ka humbur mbi 7 kg në peshë. Dhe vetë prindërit e kanë vënë re këtë ndryshim në sjelljen e vajzës së tyre.

dhe të pranojnë abuzimin, ndërsa djemtë janë të prirur të zemërohen duke i lënë rrugë sjelljes agresive.

- Një karakteristikë e përbashkët që vihet re tek viktimat e dhunës seksuale është paaftësia për t'u besuar njerëzve.
- Ndjenja e fajit e shoqëron për një kohë të gjatë viktimën, dhe kur ai/ajo nuk merr ndihmë psikologjike, kjo ndjenjë vazhdon gjatë gjithë jetës (*Shumica e viktimave karakterizohen nga ndjenja e braktisjes dhe moskërkesa e ndihmës*). Ndjenja e fajit i bën fëmijët dhe të rinjtë të ndihen ndryshe nga bashkëmoshatarët e tyre, duke u mohuar atyre mundësitë dhe gëzimet e një jete normale.
- Fëmijët që dhunohen seksualisht dhe e mbajnë sekret atë, vuajnë më shumë psikologjikisht sesa ata që e raportojnë atë dhe marrin mbështetje psikologjike. Pasojat vazhdojnë gjatë adoleshencës dhe rinisë, duke mos patur mundësi për një jetë të rrituri të shëndetshëm.
- Doktor William C. Holmes i

Universitetit të Pennsilvanisë, Fakultetit së Mjekësisë, thotë se në Shtetet e Bashkuara një e treta e kriminelëve të moshës së re, përkatësisht: 40% e dhunuesve seksualë të regjistruar dhe 76% e përdhunuesve të vazhdueshëm, ishin abuzuar seksualisht kur ishin fëmijë ose të rinj. Përveç kësaj, përqindja e vetëvrasjes të djemve të abuzuar seksualisht ishte 14 herë më e lartë.

- Viktimat e abuzimeve seksuale e kanë të vështirë të kenë marrëdhënie të shëndosha me partnerin/en dhe shoqërinë, pasi i persekuton ndjenja e fajit, mëria dhe urrejtja, nuk mund të kenë marrëdhënie seksuale normale, të kuptojnë seksualitetin e tyre si diçka jo vetëm gjenitale, etj.
- Viktimizimi i vetvetes dhe vetëvlerësimi i ulët vihet re tek vajzat dhe djemtë dhe ndikon thellësisht në arritjet dhe suksesin e individit gjatë jetës.
- Vajzat e reja që janë të detyruara të kenë marrëdhënie seksuale, janë mbi 3 herë më të prirura të zhvillojnë çorganizime

psikologjike ose abuzim me alkool dhe drogë sesa vajzat e paabuzuara.

- Gjithashtu, një karakteristikë e fëmijëve të dhunuar janë çrregullimet në të ushqyerit, siç është anoreksia apo të mbigrënit dhe probleme të urinimit, duke humbur aftësinë për të kontrolluar këto aspekte të rëndësishme në jetën e tyre si pasojë e çrregullimeve emocionale.

Trafikimi - një e ardhme e dhunuar!

Trafikimi i fëmijëve dhe të rinjve është lënë mënjanë nga studiuesit e dhunës, pasi anashkalohet fakti se trafikimi sjell një dëmtim të jetës të një fëmije apo të riu/reje duke i mohuar të drejtën për arsimim dhe kushtet e një jete normale. Nga një studim i kryer nga UNDP (Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara) dhe (INSTAT) Instituti i Statistikës në Tiranë është arritur në rezultatin se rreth 5 mijë fëmijë shqiptarë janë trafikuar vitet e fundit në vendet

fqinje, si: Italia dhe Greqia. Në raport thuhet se shkak i një numri kaq të lartë fëmijësh që trafikohen, është mungesa e rendit publik dhe siguria. Fëmijët të cilët gjenden më shpesh në rrezik për t'u trafikuar janë fëmijët jetimë në familje, jetimë në institucione, fëmijët e ngujuar në zonat rurale, si dhe fëmijët që braktisin shkollën dhe punojnë. Këto kategori fëmijësh bien viktimë dhe trafikohen jashtë kufijve ku ata detyrohen të lypin, vjedhin, dhe ushtrojnë prostitucionin. Është konstatuar nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara se Shqipëria është një vend tranzit dhe origjine i vajzave dhe grave, të cilat përdoren për qëllime prostitucioni në vendet perëndimore. Ato vijnë nga Moldavia, Rumania, Bullgaria, Ukraina, por dhe vetë nga Shqipëria. Ndër arsyet e trafikimit mund të radhisim dhunën në familje, varfërinë, mungesën e shtetit ligjor, imazhet e përcjella nga media, si dhe mungesën e një mekanizmi kombëtar për të reduktuar dhe eliminuar këtë dukuri. Në këtë kuadër, shumë fëmijë janë detyruar të braktisin

shkollën dhe të angazhohen në veprimtari të rrezikshme për të ardhmen e tyre, si trafikimi, etj. Gjithashtu, anasjelltas mund të themi se mungesa e një strukture arsimore funksionale në Shqipëri ka bërë që shumë fëmijë të privohen nga e drejta për një shkollim të mirë dhe të angazhohen në trafikim apo veprimtari të rrezikshme dhe të dhunshme.

Historia e Ermalit:

“Unë asnjëherë nuk kam shkuar në shkollë kur isha i lirë, por tani që jam këtu brenda (paraburgim) e ndiej mungesën e saj. Nëse do të na lejonin të shkoni në shkollë këtu ku jemi kjo do të thyejte monotoninë e qëndrimit, ne do të ishim më të zgjuar dhe nuk do të vazhdonim në rrugën e krimit.”

-një minoren në paraburgim-

Dhuna dhe imazhet në media

Nëpër televizionet tona shihen shpesh imazhe të dhunshme, verbale, fizike, seksuale, psikologjike, etj. Kjo gjë ndikon negativisht më shumë tek fëmijët dhe të rinjtë, duke ua paraqitur atë si një mjet zgjidhjeje ndaj problemeve të jetës së përditshme. Nga një studim i kryer nga Kompania Amerikane TV Guide në 1995, u konstatua se filmat vizatimorë kishin dhe pasqyronin skenat më të dhunshme. Më pas, vinin promovimet dhe spektaklet televizive, filmat, lojërat fitimprurëse, videot muzikore dhe reklamat e filmave. Në shoqërinë tonë, duhet patur parasysh që liria e medias nuk duhet të kthehet në lirinë e përshkrimit të imazheve negativë për fëmijët dhe të rinjtë. Gjuha seksiste dhe përshkrimi i femrës si vetëm një mjet argëtimi, duhet të eliminohen dhe të merren masa kufizuese për filmat, mesazhet dhe imazhet pornografikë në kanalet televizive, të cilët shfaqen

gjatë orëve të mbrëmjes. Të mos harrojmë që dhuna është një sjellje e mësuar dhe jo e trashëguar. Në këtë kontekst, media është e përgjegjshme të inkurajojë eliminimin e dhunës dhe të mos e trajtojë këtë problem shoqëror si një fenomen privat dhe normal të shoqërisë shqiptare.

- *Cilat mendoni ju janë pasojat në marrëdhëniet shoqërore n.q.s. Artani vazhdon të luajë vetëm me lojërat ushtarake? A mendoni ju se sjellja e tij do të ndikohet nga imazhet e dhunshme me të cilat ai luan?*
- *Cilat janë përgjegjësitë e prindërve të Artanit në këtë rast në lidhje me edukimin të birit?*

Historia e Artanit:

Ka disa javë që shokët e Artanit nuk e shohin atë të dalë më të luajë jashtë me ta pasi atij i kanë blerë prindërit 'Play Station 2' dhe disa lojëra luftërash, të cilat reflektojnë imazhe të dhunshme ushtarake. Këto lojëra nuk rekomandohen për fëmijët nën moshën 13 vjeçare dhe Artani është vetëm 9. E ëma e Artanit është e kënaqur, sepse nuk e ka më të nevojshme ta kontrollojë djalin e saj që nga ballkoni kur luante jashtë dhe i ati ka mundësi të punojë në studion e tij, pa qenë i ndërprerë vazhdimisht nga i biri.

Parandalimi i dhunës – një përgjegjësi shoqërore

► *Kuadri ligjor*

Shteti Shqiptar ka hartuar një strategji të posaçme për sigurinë dhe të drejtat e fëmijëve, të cilët gëzojnë një mbrojtje të veçantë prej tij. Gjithashtu, është ratifikuar Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila përdoret si një udhëzues i objektivave dhe strategjive të Qeverisë Shqiptare në këtë fushë. Në këtë konventë, konfirmohen të drejtat civile, ekonomike, sociale, kulturore, politike etj., të fëmijëve duke pasur si qëllim krijimin e një strategjie kombëtare e cila përputhet me standartet ndërkombëtare.

Duke u bazuar në nenin 54 të Kushtetutës Shqiptare, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja janë të siguruara nga një mbrojtje e veçantë e shtetit (këtu përfshihet çdo fëmijë i lindur brenda apo jashtë martese). Gjithashtu, çdo fëmijë gëzon të drejtën të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi,

dhe shfrytëzimi për të punuar (sidomos nën moshën minimale), e cila mund të dëmtojë shëndetin, moralin apo të rrezikojë jetën e zhvillimin e tij/saj normal. Për më tutje, gjejmë dispozita të veçanta në Kodin Penal dhe Civil përsa i përket respektivisht mbrojtjes së fëmijëve nga krimet kundër tyre dhe të drejtën për të kryer veprime juridike (mbi moshën 14 vjeç).

► *Përgjegjësitë e shoqërisë*

Shpeshherë ne kemi tendencën të izolohejmë në botën tonë duke injoruar ngjarjet negative përreth nesh... derisa një ditë ato na ndodhin ne. Më pas, gjithçka ndryshon dhe bëhet personale dhe problemet e të tjerëve bëhen tonat. A duhet të presim derisa këto probleme të trokasin në dyert tona për t'i luftuar? Çfarë mund të bëjmë në mënyrë që t'i zgjidhim ato?

Dhe pse pak është e njohur sot, studime të ndryshme kanë bërë të ditur disa nga faktorët mbrojtës për përjetimin e dhunës ndaj fëmijëve dhe të rinjve. Disa nga këta faktorë mund të rradhiten: mundësitë ekonomike, këshilluesit dhe modelë(e)t të cilëve ata u referohen dhe japin një ndjenjë zhvillimi moral; komuniteti në të cilin jetojnë, programet mbështetës në shkollën ku ata mësojnë, angazhimi në aktivitete jashtë shkollore dhe një familje normale gjatë jetës si i rritur.

Parandalimi i dhunës tek fëmijët dhe të rinjtë, do të thotë në radhë të parë që ata të mos jenë të pranishëm në mjedise ku përdoret dhuna apo të dhunohen dhe këtu kemi parasysh të gjitha format e dhunës. Lidhja e drejtpërdrejtë e dhunës ndaj grave, fëmijëve dhe të rinjve, ka nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të programeve mbështetëse për ta. Programet parandaluese kundër dhunës ndaj grave dhe fëmijëve janë diçka e re, por tepër efikase për uljen e përqindjes së dhunës në familje. Përmirësimi i metodave

parandaluese, çon në krijimin e një procesi apo sistemi, i cili formalisht apo jo, ndihmon prindërit dhe fëmijët.

Mbi mënyrat e reduktimit të dhunës ndaj fëmijëve dhe të rinjve, ka shumë ndikim mjedisi dhe komuniteti. Në këtë kontekst, rekomandimet e mëposhtme mund të shërbejnë si strategji efikase parandalimi të dhunës:

- Asistenca psikologjike dhe përfshirja e komunitetit (nëpërmjet programeve të ndryshme) për zgjidhjen e problemit të dhunës dhe angazhimi i familjeve ku rrezikohet apo përdoret dhuna, për të pranuar ndihmë. Kjo bën të mundur që prindërve t'u jepen aftësitë e nevojshme për një komunikim paqësor me fëmijët e tyre si dhe me njëri - tjetrin.
- Krijimi i programeve komunitare për fëmijët dhe të rinjtë ku ata mund të mblidhen dhe të flasin për problemet e tyre si dhe trajnime për zgjidhjen paqësore të konflikteve. Këtu do të ishin një prioritet

programet e përshtatura për fëmijët dhe të rinjtë ku mund të ndihmohen psikologjikisht dhe të përballojnë problemet që lidhen me dhunën.

- Zbatimi i programeve këshilluese nëpër institucionet edukuese për të kuptuar problemet psikologjike dhe shëndetësore ndaj fëmijëve dhe të rinjve të dhunuar dhe mënyrat për t'i ndihmuar ata të përballojnë dhe zgjidhin problemin. Një përpjekje efikase është caktimi i një këshilluesi apo psikologu në çdo institucion shkollor për të qenë pranë problemeve të fëmijëve dhe të rinjve. Krijimi i programeve apo grupeve studentore në shkollat e mesme, për të trajtuar çështjet e dhunës dhe për t'u informuar mbi rrezikshmëritë e pasojave të saj. Shkollat mundën të ofrojnë programe mbi mënyra paqësore të menaxhimit të konflikteve për adoleshentet, të cilët rrezikohen të bëhen të dhunshëm. Ndërhyrja paraprake mund të arrihet nëpërmjet trajnimeve të

personelit mësimdhënës në shkolla apo institucione të ndryshme dhe ofrimi i një ambienti mbështetës për viktimat e dhunës në familje. Është konstatuar se shumica e vajzave, të cilat kanë qenë viktimat të abuzimit, fizik apo seksual dhe inçestit, paraqesin më shumë rrezik për të mbetur shtatzëna. Shtatzania mund të jetë një pasojë e drejtpërdrejtë e dhunës seksuale nga partneri apo përdhunimi nga një i panjohur, si rrjedhojë e përfshirjes në një sjellje të rrezikshme, si pasojë e dhunës së ushtruar në familje. Në këtë kontekst, qendrat e këshillimit për vajzat e reja janë mjaft efikase. Aksesit ndaj informacionit për dhunën fizike apo seksuale në familje apo nga partneri, si dhe qendrat apo linjat telefonike, ku mund të drejtohen janë prioritete sidomos për shkollat e mesme.

- Hartimi dhe zbatimi i një strategjie kombëtare lidhur me rolin e medias në imazhin që i japin dhunës në sytë

e fëmijëve. Kjo mund të arrihet nëpërmjet kontrollit të kanaleve televizive nga prindërit të cilat japin filma, dokumentarë dhe këngë ku vërehet ushtrimi i dhunës, si një dukuri e pranueshme shoqërore.

► ***Këshilla për prindërit***

- Ofrojini fëmijës tuaj kujdes dhe dashuri. Çdo fëmijë e ka të nevojshme një lidhje të fortë kujdesi dhe dashurie me prindin, në mënyrë që të ndihet i/e qetë dhe i sigurtë, pasi mungesa e saj shkakton mundësinë e të sjellurit ashpër dhe vështirësi në komunikim. Është e nevojshme të kujtojmë se fëmijët kanë botën e tyre dhe se durimi dhe vullneti për t'i kuptuar ata janë karakteristika themelore në marrëdhëniet prindër-fëmijë.
- Kini kujdes që fëmijët tuaj të jenë të mbikqyrur. Kjo, pasi fëmijët varen nga prindërit e tyre për t'u dhënë siguri, kurajo dhe mbështetjen e nevojshme, për të menduar

dhe vepruar vetë.

- Bëhuni shembull i sjelljes për fëmijën tuaj! Parimi që shumë prindër përdorin “bëj si të them unë, por mos bëj si bëj unë” shkakton një ndjenjë pasigurie tek fëmijët, të cilët përballen me një sjellje të dyshimtë të prindërve të tyre. Tregojuni, me veprimet tuaja, se cilat janë parimet e drejta, që ju doni të aplikohen nga fëmijët tuaj.
- Kurrë mos i godisni fëmijët tuaj, pasi dhuna nuk është disiplinë dhe nuk është një mënyrë e pranueshme për të zgjidhur problemet. Gjeni kompromiset e përshtatshme për të disiplinuar fëmijët tuaj, pa i bërë ata të ndihen të ndrydhur dhe të dhunuar.
- Jini të qëndrueshëm në rregullat dhe disiplinën e vënë ndaj fëmijës tuaj. Fëmijët kanë nevojë për një strukturë dhe moszbatimi i rregullave të vendosura shkakton që fëmijët të eksperimentojnë me kufizimet dhe limitet e këtyre rregullave.
- Mos i ekspozoni fëmijët tuaj

ndaj armëve dhe mjeteve të tjera të dhunës, pasi ato përbëjnë rrezik për jetën e tyre dhe tuajën. Nuk janë të pakta rastet në vendin tonë, kur moskontrollimi i armëve nga prindërit ka shkaktuar humbjen e jetëve të shumë prindërve e fëmijëve.

- Mundohuni të mos i ekspozoni fëmijët tuaj ndaj dhunës në shtëpi, komunitet apo media. Fëmijët kanë nevojë të ndihen të sigurtë në familjen e tyre dhe në komunitetin përreth. Kufizoni kohën e tyre në televizion dhe kontrolloni materialet e dhunshme që

vërehen aty.

- Flisni me fëmijët tuaj mbi dhunën dhe efektet e saj dhe se si mund të eliminohet viktimizimi ndaj saj në ambjentet shkollore, ku fëmijët mund të ndihen të ndrydhur nga sjellja e papërshtatshme e moshatarëve të tyre. Ndhimojini fëmijët tuaj të mos i tolerojnë sjelljet e dhunshme dhe si t'i eliminojnë ato.
- Mbështesni lëvizjet dhe nismat kundër dhunës në komunitetin dhe shoqërinë tuaj. Në këtë mënyrë, ju vendosni veten tuaj si një shembull apo model në sytë e fëmijëve tuaj.

Historia e Enit:

“Kisha nevojë që dikush të më kishte pyetur sesi dhuna e ushtruar tek unë nga im atë më bënte të ndihesha. Fundja, dhe nga nëna ime e cila dhunohej gjithashtu. Por, të gjithë heshtnin dhe pse e dija që të gjithë e dinin. Në shkollë shoqet mënjanoreshin prej meje dhe pse disa prej tyre kishin të njëjtin problem. Mesa duket, mendonin se shpallja e problemit i bënte dhe ato fajtoje. Të gjithë të afërmit, përfshirë dhe nënën time, më thonin se duhej të duroja, se kështu e kanë burrat. Nëna më thoshte se kishte duruar dhe duronte tim atë për hirin tim dhe të motrës. Por, unë nuk e doja një sakrificë të tillë, ndihesha fajtoje për një vendim që nuk e kisha marrë unë. Dhe pse duhej që një 16 vjeçare e mbyllur në vetvete të duronte një ndrydhje të tillë gjatë gjithë jetës? Nuk doja kurrë që historia e prindërve të mi të përsëritej me mua. Refuzova të mbetesha një viktimë dhe kërkova ndihmë tek qendra më e afërt e këshillimit.”

*Ndihesh dhe ti i/e dhunuar fizikisht,
psikologjikisht apo seksualisht?*

*Reago tani,
kontakto me qendrën e këshillimit më të afërt!*

Kontakte të nevojshme:

Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza “Mos hesht!”

Rr. “Pjetër Bogdani”, P. 39/1 Ap 6/1
Kutia Postare 2416/1, Tiranë
Tel: 04 233 408
E-mail: qkgv@albnet.net

Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Durrës

Rr. “Skënderbej”, Lagjia 3, pranë
shkollës “Jan Kukuzeli”
Tel. & Fax: 052 24 962
E-mail: bceveli@yahoo.com

Strehëza për Gratë dhe Vajzat e Dhunuara

Tel: 04 233 408
Tiranë

Qendra e Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza, Shkodër

Rr. “13 Dhjetori”
Tel. 022 42 213
E-mail: qkgv@albnet.net

Qendra e Këshillimit, Pogradec

Rr. “Reshit Çollaku”
Tel: 083 22 140

Gruaja tek Gruaja

Rr. “Marin Barleti” sipër Kristalit
Tel. 022 41154 (fax)
Shkodër
E-mail: gtg@adanet.com.al

Unë, Gruaja

Rr. “Reshit Çollaku”
Pogradec
Tel. & Fax: 0832 5104

Forumi i Gruas, Elbasan
Lagjia "Aqif Pasha", Rr. "28
Nëntori". P. 77/5
Tel: 054 54 516
E-mail: ccawgel@enet.org.al

**Qendra e Këshillimit për Gra
dhe Vajza, Berat**
Pallati i Kulturës
Tel: 032 31 004
E-mail: qkgvberat@yahoo.com

Shoqata "Refleksione"
Rr. Elbasanit, P. "Fratari", Tershan
2, Kati I
Tiranë
Tel: 04 340 433
Fax: 04 340 432
E-mail: refleksione@albnet.net;
refleksione@icc-al.org
Faqja e internetit: www.
refleksioneassoc.org/

**Qendra për Nisma Ligjore
Qytetare (Ish-Qendra Avokatore
e Gruas)**
Rr. "Vaso Pasha", P. 12, Shk. 1.
Ap. 1
Tiranë
Tel: 04 259 795
Tel. & Fax: 04 241 419
E-mail: avokatore@albmail.com
Faqja e internetit: www.qag-al.org

**Qendra e Trajtimit MultiDisiplinor
për Problemet e Keqtrajtimit të
Fëmijëve**
Rr. "Pjetër Bogdani"
P. Teuta, Kati 3/4
Tel: 04 267 038
04 230 820
E-mail: chabuse@albaniaonline.net

**Qendra për Mbrojtjen e të
Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
-CRCA**
Pallatet e Shallvareve, Vila mbrapa
fushave të Tenisit, Kati 3
Kutia Postare Nr. 1738, Tiranë
Tel / Fax: 04 242264
E-mail: crca@crca.org.al

Faqja e internetit: www.crca.org.al

**Kryqi i Kuq Shqiptar (Zyra
Qendrore)**
P.O. BOX 1511
Tiranë
04 225855

**Kryqi i Kuq Spanjoll (Zyra
Qendrore)**
Rr. "Budi" P. Classic Construction
Tiranë
Tel. 04 378380

**Qendra e Aleancës Gjinore për
Zhvillim (Ish-Qendra e Gruas)**

Rr. "Abdyl Frashëri" P. 10 Shk.1. Ap. 3

Kutia Postare 2418

Tel: 04 255 514/5

Te. & Fax: 04 255 515

E-mail: info@women-center.tirana.al

Faqja e internetit: www.women-center.org.al

Referencat

- Këshilli Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe nga Zyra e Dhunës ndaj Grave – Shtetet e Bashkuara të Amerikës.
- Zyra për Parandalimin e Dhunës në Familje e New York-ut.
- Departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Shëndetin dhe Shërbimet Njerëzore, Administrimi për Fëmijët dhe Familjet.
- Shoqëria Amerikane e Psikologjisë.
- Abuzimi i Fëmijëve në Familjet Shqiptare" (Draft), përgatitur nga Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri- CRCA, Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri- IRCCRA, Olof Palme International -me qendër në Suedi dhe Defence for Children International- DCI. Tiranë-2005.
- Raport i Qendrës së Trajtimit MultiDisiplinor për Problemet e Keqtrajtit të Fëmijëve "Situata e Keqtrajtit të Fëmijëve në Familje dhe në Ambientin Shkollor në Tiranë dhe Rrethina" 2005.
- Dhuna në familje shkatërron jetën e grave dhe të fëmijëve si dhe pengon zhvillimin e mëtejshëm të Shqipërisë, UNICEF 17 Shtator, 2003.
- Raporte – UNDP + INSTAT